LIGJ
Nr.9964, datë 24.7.2008

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS JAPONEZE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMEVE PËR TIRANËN E MADHE""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për financimin e projektit "Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e Madhe"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5847, datë 30.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Marrëveshje huaje nr.ABA-P3

MARRËVESHJE HUAJE
PËR PROJEKTIN E PËRMIRËSIMIT TË SISTEMIT TË KANALIZIMEVE NË TIRANËN E MADHE NDËRMJET BANKËS JAPONEZE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Marrëveshja e huasë nr. ABA-P3, e datës ○○, 2008, ndërmjet BANKËS JAPONEZE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR dhe QEVERISE SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË.

Duke marrë parasysh përmbajtjen e shkëmbimit të notave ndërmjet Qeverisë së Japonisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të datës 15 prill 2008, në lidhje me një hua japoneze që duhet të zgjerohet, me synim nxitjen e stabilitetit ekonomik dhe përpjekjeve të zhvillimit të Republikës së Shqipërisë,

Banka Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (në vijim e referuar si "Banka") dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë (në vijim referuar si "Huamarrësi") në këtë mënyrë nënshkruajnë Marrëveshjen e mëposhtme të Huasë (në vijim referuar si "Marrëveshja e huasë", që përfshin të gjitha marrëveshjet plotësuese të saj).

Neni 1
Huaja

Seksioni 1. Shuma dhe qëllimi i huasë

Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit një shumë që nuk tejkalon njëmbëdhjetë miliardë e njëqind e njëzet e një milionë jenë japonezë (¥ 11 121 000 000) si principal për implementimin e projektit të përmirësimit të kanalizimeve të Tiranës së Madhe, të përshkruar në programin 1 të bashkëlidhur në këtë dokument (në vijim referuar si "Projekti") mbi termat dhe kushtet e parashtruara në Marrëveshjen e huasë dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse të Japonisë (në vijim referuar si "Huaja"), megjithatë, me kusht që kur totali kumulativ i disbursimeve, sipas Marrëveshjes së huasë, arrin kufirin e lartpërmendur, Banka nuk duhet të bëjë asnjë disbursim të mëtejshëm.

Seksioni 2. Përdorimi i shumave të huasë

1. Huamarrësi do të kujdeset që shumat e huasë të përdoren për blerjen e mallrave dhe shërbimeve të pranueshme, të nevojshme për implementimin e projektit nga furnizuesit, kontraktorët ose konsulentët (në vijim kolektivisht të referuar si "Furnizuesi (t)") e vendit (eve) të pranueshme të origjinës të përshkruar/a në programin 4 të bashkëlidhur në këtë dokument (në vijim referuar si "Vendi (et) e pranueshme të origjinës") në përputhje me alokimin e përshkruar në programin 2 të bashkëlidhur në këtë dokument.

2. Disbursimi përfundimtar sipas Marrëveshjes së huasë duhet të bëhet jo më vonë sesa e njëjta ditë dhe muaj, shtatë (7) vjet pas datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së huasë dhe më pas nuk do të bëhet asnjë disbursim i mëtejshëm nga Banka, nëse nuk bihet dakord ndryshe ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit.

Neni 2
Shlyerja, interesi dhe tarifa e detyrimit financiar

Seksioni 1. Shlyerja e principalit

Huamarrësi do të shlyejë principalin e huasë ndaj Bankës në përputhje me programin e pagimit në disa këste, të parashtruar në Programin 3 të bashkëlidhur në këtë dokument.

Seksioni 2. Interesi dhe metoda e pagesës së tij

1. Huamarrësi do t'i paguajë interesin Bankës mbi baza gjashtëmujore në normën prej zero pikë gjashtëdhjetë e pesë për qind (0.65%) në vit mbi principalin që i korrespondon kategorive (a) dhe (b) të disbursuara më poshtë (në vijim referuar si "Principali (I)") dhe të papaguara:

a) principali i disbursuar nga shumat e huasë, alokuar në kategoritë (A) dhe (C)- i) (parashikuar në seksionin 1. të programit 2 të bashkëlidhur në këtë dokument);

b) çdo principal i rialokuar nga kategoria (D) (i parashikuar në seksionin 1 të programit 2 të bashkëlidhur në këtë dokument) dhe i disbursuar në lidhje me pikën (1) (a) më lart.

2. Huamarrësi do t'i paguajë interes Bankës mbi baza gjashtëmujore në normën prej zero pikë zero një për qind (0.01%) në vit mbi principalin që i korrespondon kategorive (a) dhe (b) të disbursuara më poshtë (në vijim referuar si "Principali (II)") dhe i papaguar:

a) principali i disbursuar nga shumat e huasë, alokuar në kategorinë (B) dhe (C)-ii) (parashikuar në seksionin 1 të programit 2 të bashkëlidhur në këtë dokument);

b) çdo principal i rialokuar nga kategoria (D) (i parashikuar në seksionin 1 të programit 2 të bashkëlidhur në këtë dokument) dhe i disbursuar në lidhje me pikën (2) (a) më lart.

3. Huamarrësi do t'i paguajë Bankës: i) para datës së përfundimit të disbursimit të shumave të huasë (në vijim referuar si "Data e përfundimit") në datën 20 korrik të çdo viti interesin që është shtuar deri në datën 19 qershor të atij viti nga data 20 dhjetor e vitit paraardhës dhe më 20 janar të çdo viti interesin që është shtuar deri në 10 dhjetor nga 20 qershori i atij viti, dhe ii) pas datës së përfundimit, më 20 qershor të çdo viti interesin që është shtuar deri më 10 qershor të atij viti nga data 20 dhjetor i vitit paraardhës dhe më 20 dhjetor të çdo viti interesin që është shtuar deri në 19 dhjetor nga 20 qershori i atij viti.

4. Pavarësisht nga nënseksioni i mësipërm, kur data e përfundimit është jo më e hershme sesa tre (3) muaj nga 20 korriku ose 20 janari, pagesa e interesit të parë pas datës së përfundimit do të bëhet më 20 korrik ose 20 janar, cilado që vjen e para.

Seksioni 3. Tarifa e detyrimit financiar dhe metoda e pagesës së tij

1. Huamarrësi do të paguajë tarifën e detyrimit financiar (në vijim referuar si "Tarifa e detyrimit financiar") ndaj Bankës mbi baza gjashtëmujore në normën prej zero pikë një për qind (0.1%) në vit mbi bilancin total të papërdorur të shumës që hyn në kategoritë (A) (B), (C) dhe (D) të parashtruar në programin 2, bazuar në metodën e llogaritjes së përcaktuar në seksionin 1, (4) të nenit 3 për periudhën nga njëqind e njëzet (120) ditë pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes së huasë deri në datën e përfundimit; megjithatë, me kusht që nëse data e përfundimit nuk është ditë punë, një ditë punë që vjen menjëherë më pas do të konsiderohet datë përfundimi.

2. Huamarrësi do t'i paguajë Bankës: i) para datës së përfundimit, më 20 korrik të çdo viti tarifën e detyrimit financiar që është shtuar deri në 10 qershor të atij viti nga 20 dhjetori i vitit paraardhës dhe më 20 janar të çdo viti tarifën e detyrimit financiar që është shtuar deri në 10 dhjetor nga 20 qershori i atij viti, dhe ii) pas datës së përfundimit, më 20 qershor, menjëherë pas datës së përfundimit, tarifën e detyrimit financiar që është shtuar deri në datën e përfundimit nga 20 dhjetori i vitit paraardhës ose në 20 dhjetor, menjëherë pas datës së përfundimit, tarifën e detyrimit financiar që është rritur deri në datën e përfundimit nga 20 qershori i atij viti, cilado që vjen e para.

3. Pavarësisht nga nënseksioni i mësipërm, pagesa e tarifës së detyrimit financiar do të fillojë më 20 korrik 2010 ose në një datë të mëvonshme të caktuar nga Banka (në vijim referuar si "Data e caktuar"). Tarifa e detyrimit financiar, deri një (1) muaj para datës së caktuar, do të paguhet tërësisht në datën e caktuar pa ndonjë interes mbi të. Huamarrësi do t'i paguajë Bankës ose më 20 janar, ose më 20 korrik, menjëherë pas datës së caktuar, cilado që vjen e para, tarifën e detyrimit financiar që është shtuar deri në 19 dhjetor ose 19 qershor, si të jetë e zbatueshme, nga një (1) muaj para datës së caktuar.

4. Pavarësisht nënseksionit (2) më lart, kur data e përfundimit nuk është më e hershme sesa tre (3) muaj nga 20 korriku ose 20 janari, pagesa e tarifës së detyrimit financiar pas datës së përfundimit do të bëhet ose në 20 korrik ose në 20 janar, cilado që vjen e para.

5. Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit tërësisht dhe jo pjesërisht shumën e barasvlershme me shumën e tarifës së detyrimit financiar, që duhet të llogaritet dhe referohet në seksionin 3(1) të nenit 2 si principal nga shumat e huasë, me përjashtim të shumës së barasvlershme me pagesën e tarifës së detyrimit financiar të kërkueshme dhe të pagueshme pas datës së përfundimit, nëse nuk bihet dakord ndryshe ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit.

Seksioni 4. Pagesa e pamjaftueshme

Nëse shuma e ndonjë pagese të bërë nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes së huasë është më e vogël sesa shuma totale e kërkueshme dhe e pagueshme, Huamarrësi bie dakord që shuma e pagesës së bërë të aplikohet dhe të përvetësohet në rendin e mëposhtëm: i) tarifa e vonuar, ii) tarifa e detyrimit financiar, iii) interesi dhe iv) principali. Pavarësisht sa më sipër, Banka mund të aplikojë dhe përvetësojë shumën e pagesës së marrë në rendin e vendosur nga ajo vetë, me zgjedhjen e saj të vetme.

Neni 3

Marrëveshje të Veçanta

Seksioni 1. Termat dhe kushtet e përgjithshme

Termat dhe kushtet e tjera përgjithësisht të zbatueshme ndaj Marrëveshjes së huasë do të parashtrohen në termat dhe kushtet e përgjithshme të Bankës për huatë ODA të tetorit 1999, me përcaktimet e mëposhtme plotësuese (në vijim referuar si "Termat dhe kushtet e përgjithshme"):

1. Termi "principal" sa herë që përmendet në termat dhe kushtet e përgjithshme zëvendësohet me "Principal (I) dhe Principal (II)".

2. Seksioni 3.04. i termave dhe kushteve të përgjithshme nuk merret në konsideratë.

3. Seksioni 3.05 (1) i termave dhe kushteve të përgjithshme lexohet si më poshtë:

Nëse shlyerja e principalit ose pagesa e interesit të kërkuar sipas Marrëveshjes së huasë shtyhet, interesi i specifikuar në seksionin 3.03 do të pushojë të shtohet mbi një shumë principali të tillë të vonuar në ose pas datës së caktuar dhe një tarifë e vonuar e llogaritur në një normë prej dy për qind (2%) në vit mbi normën e interesit të specifikuar në Marrëveshjen e huasë, do të jetë e

pagueshme mbi shumën e vonuar të principalit ose interesit për një periudhë nga data e caktuar deri në ditën që paraprin menjëherë ditën e pagesës aktuale të tij, duke përfshirë të dyja.

4. Seksioni 3.06. i termave dhe kushteve të përgjithshme lexohet si më poshtë:

Interesi, tarifa e detyrimit financiar dhe tarifa e vonuar shtohen ditë pas dite dhe llogariten mbi bazën e treqind e gjashtëdhjetë e pesë (365) ditëve dhe numrit aktual të ditëve të kaluara.

5. Për sa i përket seksionit 3.07 të termave dhe kushteve të përgjithshme, Huamarrësi do t'iketë kredituar të gjitha pagesat e principalit dhe të interesit dhe tarifat e tjera mbi huanë në numrin e llogarisë "ODA-JBIC" 0207787 në Bankën e Tokyo-Mitsubishi UFJ, Ltd., zyra kryesore, Japoni.

6. Seksioni 3.09 i termave dhe kushteve të përgjithshme lexohet si më poshtë:

Kur e çmon të nevojshme, Banka mund t'i dërgojë Huamarrësit një njoftim në lidhje me tarifën e detyrimit financiar, interesin dhe principalin (Formulari JBIC nr.1 i bashkëlidhur në këtë dokument).

Formulari nr.1 zëvendësohet me formularin – JBIC NCCIP të bashkëlidhur në këtë dokument për njoftimin në lidhje me tarifën e detyrimit financiar, interesin dhe principalin e kërkuar në dhe pas datës së caktuar.

7. Seksioni 4.04 i termave dhe kushteve të përgjithshme lexohet si më poshtë;

Pasi një kontratë është konsideruar e pranueshme për financimin e Bankës, emrat e të gjithë ofertuesve, çmimet e ofertave të tyre (përveçse në rast të punësimit të konsulentit), emri dhe adresa e ofertuesit të suksesshëm për sa i përket lidhjes së kontratës, emri dhe adresa e furnizuesit dhe data e lidhjes dhe shuma e kontratës mund të bëhen publike nga Banka. Huamarrësi do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që informacioni i mësipërm të vihet në dispozicion për t'u bërë publik, i përfshirë në dokumentet në lidhje me prokurimin, si dokumentet dhe kontratat e tenderit.

8. Paragrafi i parë i seksionit 5.06 (1) i termave dhe kushteve të përgjithshme lexohet si më poshtë;

Pas realizimit të disbursimit përfundimtar nga kategoritë (A) deri në (D) të përcaktuara në seksionin 1 të programit 2 sipas Marrëveshjes së huasë, Banka i dërgon Huamarrësit një njoftim në dy kopje për përfundimin e disbursimit

(Formulari nr.3, i bashkëlidhur në këtë dokument).

Formulari nr.3 zëvendësohet nga formulari – JBIC NCD i bashkëlidhur në këtë dokument, për njoftimin e përfundimit të disbursimit në dhe pas datës së caktuar.

9. Paragrafi i dytë i seksionit 5.06 (1) të termave dhe kushteve të përgjithshme lexohet si më poshtë;

Kur totali kumulativ i disbursimeve është më i vogël sesa shuma e huasë dhe nuk kërkohet asnjë disbursim i mëtejshëm për projektin, Huamarrësi i jep Bankës një njoftim me shkrim jo më pak se tridhjetë (30) ditë para datës së kërkuar të përfundimit të disbursimit.

10. Seksioni 9.03 i termave dhe kushteve të përgjithshme lexohet si më poshtë;

Çdo njoftim ose kërkesë që kërkohet të jepet ose bëhet, ose që të dyja palët kanë të drejtë të japin ose bëjnë sipas Marrëveshjes së huasë, nëse ka, do të jetë me shkrim. Një njoftim ose kërkesë e tillë do të konsiderohet të jetë dhënë ose bërë rregullisht kur të jetë dorëzuar dorazi, marrë me postë ose dërguar me postë ajrore të regjistruar për palën së cilës duhet t'i jepet ose bëhet në adresën e asaj pale të specifikuar në Marrëveshjen e huasë ose në një adresë tjetër të tillë që ajo palë do të ketë caktuar me njoftim për palën që jep njoftimin ose bën kërkesën.

Seksioni 2. Procedura e prokurimit

Udhëzimet për prokurimin dhe punësimin e konsulentëve të përmendur në seksionin 4.01 të termave dhe kushteve të përgjithshme përcaktohen në procedurën e prokurimit të bashkëlidhur në këtë dokument si programi 4.

Seksioni 3. Procedura e disbursimit

Procedura e disbursimit e përmendur në seksionin 5.01. të termave dhe kushteve të përgjithshme është si më poshtë:

1. Procedura e detyrimit financiar e bashkëlidhur në këtë dokument si programi 5 zbatohet për disbursimin e shumave të huasë për blerjen e mallrave dhe shërbimeve nga furnizuesi (t) e vendit

(eve) të pranueshme të origjinës në lidhje me pjesën e kontratës të deklaruar në monedhën e tregtueshme në mbarë botën, të ndryshme nga ajo e Republikës së Shqipërisë.

2. Procedura e rimbursimit e bashkëlidhur në këtë dokument si programi 6, zbatohet për disbursimin e shumave të huasë për pagesat e bëra furnizuesit (ve) të vendit (eve) të pranueshme të origjinës.

3. Pavarësisht nga dispozita e paragrafit (1) dhe (2) më lart, procedura e transferimit e bashkëlidhur në këtë dokument si programi 7 mund të zbatohet për disbursimin e shumave të huasë për pagesat që duhet t'i bëhen furnizuesit (eve) të vendit (eve) të pranueshme të origjinës.

Seksioni 4. Administrimi i huasë

1. Huamarrësi autorizon Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (në vijim referuar si "Agjencia ekzekutuese") si agjencia ekzekutuese.

2. Huamarrësi kujdeset që agjencia ekzekutuese të punësojë konsulentë për implementimin e projektit.

3. Nëse fondet në dispozicion nga shumat e huasë janë të pamjaftueshme për implementimin e projektit, Huamarrësi merr menjëherë masa për sigurimin e këtyre fondeve që nevojiten.

4. Nga shumat e huasë, Huamarrësi mund të nxjerrë një ose disa hua për agjencinë operuese (në vijim e referuar si "Nënhuaja") për implementimin e projektit. Termat dhe kushtet e nënhuasë nuk do të jenë më pak të favorshme sesa ato të Marrëveshjes së huasë.

5. Huamarrësi do të kujdeset që agjencia ekzekutuese t'i japë Bankës raporte ecurie për projektin çdo tre muaj (në mars, qershor, shtator dhe dhjetor të çdo viti) derisa të përfundojë projekti, në formë dhe detaje të tilla siç mund të kërkojë Banka në mënyrë të arsyeshme.

6. Menjëherë, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas përfundimit të projektit, Huamarrësi do të kujdeset që agjencia ekzekutuese t'i japë Bankës një raport mbi përfundimin e projektit në formë dhe detaje të tilla siç Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme.

7. Huamarrësi do të sigurojë që auditi para dhe mbas prokurimit të kryhet nga auditorë të pavarur që duhet të punësohen nga Banka, me qëllim sigurimin e ndershmërisë dhe konkurrencës së procedurës së prokurimit, në rastet kur Banka e çmon këtë audit të nevojshëm.

Seksioni 5. Njoftimet dhe kërkesat

Adresat e mëposhtme specifikohen për qëllim të seksionit 9.03 të termave dhe kushteve të përgjithshme:

Për Bankën
Adresa postare:
Japan bank for international cooperation (Banka Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar)
4-1, Ohtemachi 1-chome, Chiyoda-ku, Tokyo 100-8144, Japan
Në vëmendje të:
Drejtorit të Përgjithshëm,
Departamenti i Zhvillimit të Asistencës IV
Për Huamarrësin
Adresa postare:
Ministria e Financave
Bulevardi Dëshmoret e Kombit nr.1 Tirana, Albania
Në vëmendje të:
Ministrit të Financave

Nëse adresat dhe/ose emrat e mësipërm ndryshohen, pala e interesuar do të njoftojë menjëherë palën tjetër me shkrim në lidhje me adresat dhe/ose emrat e rinj.

Në dëshmi të kësaj, Banka dhe Huamarrësi, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar rregullisht, kanë bërë që Marrëveshja e huasë të ekzekutohet në mënyrën e duhur me emrat e tyre respektivë dhe të dorëzohet në zyrën e Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Chiyoda-ku, Tokio, Japoni, në ditën dhe vitin e shkruar fillimisht më lart.

PËR BANKËN JAPONEZE PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Formulari JBIC NCCIP)

Datë
Ref. nr.:

Emri dhe adresa e Huamarrësit)
Në vëmendje të:

NJOFTIM NË LIDHJE ME TARIFËN E DETYRIMIT FINANCIAR, INTERESIN DHE PRINCIPALIN

Data e caktuar në Tokio:
Detyrimi i principalit: _____
Detyrimi i interesit: _____
Detyrimi i tarifës së detyrimit financiar: _____
Totali: _____

Do të dëshironim t'ij informonim se shuma e mësipërme e specifikuar në fletën (ët) e bashkëlidhur (a) do të jetë e kërkueshme dhe e pagueshme më _____ .

Do ta vlerësonim faktin nëse pas kontrollit të shumës, ju do të kreditonit shumën e kontrolluar në llogarinë e mëposhtme deri në mesditë të datës së caktuar, me orën e Tokios.

Nr i llogarisë.:
Emri i përfituesit:
Banka e përfituesit:

Me respekt,
(Nënshkrimi i autorizuar)

Bashkëlidhur:
Në vëmendje të:

(Formulari JBIC NCD)

Datë:
Ref. Nr:

(Emri dhe adresa e Huamarrësit)

Në vëmendje të;

Zotërinj:

NJOFTIM I PËRFUNDIMIT TË DISBURSIMIT

Duke iu referuar Marrëveshjes së huasë nr._____ datë_____, me anë të kësaj ju njoftojmë se të gjitha disbursimet sipas Marrëveshjes së mësipërme të Huasë, kanë përfunduar. Hollësitë e disbursimeve sipas Marrëveshjes së huasë janë si më poshtë:

1.Kufiri i huasë (A) : _____
2.Totali kumulativ i disbursimeve (B): _____
3. Bilanci i papërdorur (A－B): _____
4. Data e disbursimit përfundimtar:
5. Data e përfundimit të disbursimit:

gjithashtu, dëshirojmë t'ju njoftojmë se Marrëveshja e lartpërmendur e huasë do të implementohet këtej e tutje si më poshtë:

1. Programi i pagesës në disa këste:
2. Datat e caktuara të pagesave të interesit:
   (1) Data e caktuar e pagesës së ardhshme:
   (2) Data e mëpasme e caktuar:
3. Datat e caktuara të pagesave të tarifave të detyrimeve financiare:
   (1) Data e caktuar e pagesës së ardhshme:
   (2) Data e mëpasme e caktuar:

Në konfirmim të këtij njoftimi, ju lutem na ktheni menjëherë një kopje të firmosur nga një person i autorizuar rregullisht.

Me respekt,

(Nënshkrimi i autorizuar)

(Ju lutem mos e hiqni)
. . . . . .

Data:

Me anë të kësaj ne pranojmë marrjen e këtij njoftimi dhe konfirmojmë se Marrëveshja e huasë do të implementohet siç deklarohet më lart.

(Emri i Huamarrësit)

PROGRAMI 1
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Seksioni 1. Përshkrimi i projektit

1. Objektivi:

Përmirësimi i cilësisë së ujërave nëntokësore dhe ujit të lumenjve lokalë me anë të zhvillimit të impiantit të trajtimit të ujërave të zeza dhe kanalizimeve në zonën e Tiranës së Madhe, duke kontribuar në këtë mënyrë në përmirësimin e higjienës publike dhe mjedisit të gjallë të banorëve të zonës së lartpërmendur.

2. Vendndodhja:

Tirana e Madhe, Shqipëri

3. Agjencia Ekzekutuese:

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

4. Agjencia Operuese

Ndërmarrja e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, Tiranë

5. Objekti i Punës:

a) Punimet civile

b) Shërbimi i konsulencës

Shumat e huasë janë të disponueshme për zërin e mësipërm (a) dhe (b).

Çdo bilanc që mbetet mbi zërat e lartpërmendur dhe të gjithë zërat e tjerë duhet të financohen nga Huamarrësi.

Seksioni 2. Kërkesat e fondit të llogaritur vjetor tregohen si më poshtë

Viti kalendarik (Jan. – Dhjet.)	për huanë (në milionë Jenë japonezë)		për projektin (në milionë jenë japonezë)	
2008	150		1,680	
2009	230		266	
2010	3,326		3,779	
2011	3,446		3,918	
2012	3,692		4,199	
2013	146		154	
2014	131		138	
Totali	11,121		14,134	

Disbursimi i shumave të huasë bëhet brenda kufirit të shumave të caktuara buxhetore vjetore të Qeverisë Japoneze për Bankën.

Seksioni 3. Përfundimi i projektit

Projekti pritet të përfundojë në dhjetor 2014.

PROGRAMI 2
ALOKIMI I SHUMAVE TË HUASË

Seksioni 1. Alokimi

Kategoria	Shuma e huasë alokuar (në milionë jenë japonezë)	% e Shpenzimeve që duhet të financohen
(A) Punimet civile dhe prokurimi i mallrave	9,238	100%
(B) Shërbimet e konsulencës	1,091	100%
(C) Interesi gjatë ndërtimit	253	—
i) në lidhje me (A) dhe (E)	252	
ii) në lidhje me (B)	1	
(D) Zërat e paparashikuar	462	—
(E) Tarifa e Detyrimit Financiar	77	—
Totali	11,121	

Shënim. Zërat që nuk pranohen për financim tregohen si më poshtë.

a) Shpenzimet e përgjithshme administrative

b) Taksat dhe tatimet

c) Blerja e truallit dhe pasurisë tjetër të patundshme

d) Kompensimi

e) Zëra të tjerë indirektë

1. Në lidhje me disbursimin në ndonjë prej kategorive (A) dhe (B), shuma që duhet të disbursohet llogaritet nga shpenzimet e pranueshme duke u shumëzuar me përqindjen e kategorisë përkatëse të treguar në këtë seksion, nëse Banka dhe Huamarrësi nuk bien dakord ndryshe.

2. Kategoria (C) tregon koston e llogaritur të interesit mbi principalin e disbursuar dhe të papaguar gjatë ndërtimit. Banka ka të drejtë të disbursojë si principal nga shumat e huasë dhe të paguajë për veten, në emër të Huamarrësit, shumat që kërkohen për plotësimin e pagesave, kur kërkohen, të interesit gjatë periudhës së ndërtimit të projektit. Ky disbursim nga shumat e huasë përbën një detyrim të vlefshëm dhe detyrues për Huamarrësin sipas termave dhe kushteve të Marrëveshjes së huasë. Data përfundimtare e këtij disbursimi e përshkruar më lart përcaktohet nga Banka.

3. Kategoria (E) tregon koston e llogaritur të tarifës së detyrimit financiar. Banka ka të drejtë të disbursojë si principal nga shumat e huasë dhe të paguajë për veten, në emër të Huamarrësit, shumat që kërkohen për plotësimin e pagesave, kur kërkohen, të tarifës së detyrimit financiar. Ky disbursim nga shumat e huasë përbën një detyrim të vlefshëm dhe detyrues për Huamarrësin sipas termave dhe kushteve të Marrëveshjes së huasë.

4. Seksioni 2. Rialokimi pas ndryshimit në preventivë

1. Nëse preventivi i zërave të përfshirë në ndonjë prej kategorive (A) deri në (C) rritet, shuma e barabartë me pjesën, nëse ka, të kësaj rritjeje që duhet të financohet nga shumat e huasë, alokohet nga Banka, me kërkesë të Huamarrësit, në atë kategori nga kategoritë e tjera përveç kategorisë (E), megjithatë, duke iu nënshtruar kërkesave për zërat e paparashikuar, të përcaktuar nga Banka në lidhje me koston e zërave të kategorive të tjera.

2. Nëse preventivi i kategorisë (E) rritet, shuma e barabartë me pjesën, nëse ka, të kësaj rritjeje që duhet të financohet nga shumat e huasë, mund të alokohet nga Banka, me kërkesë të Huamarrësit jo më pak sesa tridhjet (30) ditë para datës së kërkuar të këtij rialokimi në kategorinë (E) nga kategoritë e tjera. Shuma e kategorisë (E) nuk rialokohet në kategoritë e tjera.

3. Nëse preventivi i zërave të përfshirë në ndonjë prej kategorive (A) deri në (D) ulet, atëherë shuma e alokuar dhe që nuk kërkohet më për atë kategori, mund të rialokohet nga Banka me kërkesë të Huamarrësit jo më pak se tridhjetë (30) ditë para datës së kërkuar të këtij rialokimi në Kategorinë (E). Shuma e kategorisë (E) nuk rialokohet në kategori të tjera.

PROGRAMI 3
PROGRAMI I PAGESËS NË DISA KËSTE

1. Shlyerja e principalit (I)

Data e kërkueshme	Shuma (në jenë japonezë)
Në 20 qershor 2018	164,460,000
Çdo 20 qershor dhe 20 dhjetor Duke filluar nga 20 dhjetori 2018 deri në 20 qershor 2048	164,409,000

Shuma e huasë e alokuar në kategorinë (D) e specifikuar në seksionin 1 të programit 2 është provuar të përfshihet në "Principalin (I)".

2. Shlyerja e principalit (II)

Data e kërkueshme	Shuma (në jenë japonezë)
Në 20 qershor 2018	17,940,000
Çdo 20 qershor dhe 20 dhjetor Duke filluar nga 20 dhjetori 2018 deri në 20 qershor 2048	17,901,000

PROGRAMI 4
PROCEDURA E PROKURIMIT

Seksioni 1. Udhëzimet që duhet të përdoren për prokurimin sipas huasë

1. Prokurimi i të gjitha mallrave dhe shërbimeve, përveç shërbimeve të konsulencës që duhet të financohen nga shumat e huasë, janë në përputhje me udhëzimet sipas huave JBIC ODA të tetorit 1999 (në vijim referuar si "Udhëzimet e prokurimit").

2. Punësimi i konsulentëve që duhet të financohen nga shumat e huasë është në përputhje me udhëzimet për punësimin e konsulentëve sipas huave JBIC ODA të tetorit 1999 (në vijim referuar si udhëzimet e konsulentëve").

Seksioni 2. Vendi (et) e pranueshme të origjinës

Vendi (et) e pranueshme të origjinës për prokurimin e të gjitha mallrave dhe shërbimeve që duhet të financohen nga shumat e huasë janë të gjitha vendet dhe zonat.

Seksioni 3. Rishikimi nga ana e Bankës i vendimeve në lidhje me prokurimin e mallrave dhe shërbimeve (përveç shërbimeve të konsulencës)

1. Në rastin e kontratave që duhet të financohen nga shumat e huasë të alokuara në kategoritë (A), të specifikuara në seksionin 1 të programit 2 të bashkëlidhur në këtë dokument, në përputhje me seksionin 4.02 të termave dhe kushteve të përgjithshme, procedurat e mëposhtme do t'i nënshtrohen rishikimit dhe miratimit të Bankës. Për këto kontrata mund të miratohet procedura e ofertimit me dy

zarfe e parashikuar në seksionin 2 03 (b) të udhëzimeve të prokurimit.

1. Për sa i përket çdo kontrate vlera e të cilës llogaritet të jetë jo më pak se pesëqind milionë jenë japonezë (500 000 000):

a) Nëse Huamarrësi dëshiron të miratojë procedura prokurimi të ndryshme nga Ofertimi Konkurrues Ndërkombëtar, Huamarrësi i paraqet Bankës një kërkesë për rishikimin e metodës (ave) të prokurimit (sipas formularit nr.1 të bashkëlidhur në këtë dokument). Kur Banka nuk ka kundërshtim për dokumentet e mësipërme, Banka informon Huamarrësin për miratimin nga ana e saj nëpërmjet një njoftimi në lidhje me metodën (at) e prokurimit.

b) Kur përzgjidhen firmat e parakualifikuara, Huamarrësi i paraqet Bankës për rishikim dhe miratim, një listë të atyre firmave dhe një raport mbi procesin e përzgjedhjes me arsyet për zgjedhjen e bërë, duke bashkëlidhur të gjitha dokumentet përkatëse së bashku me një kërkesë për rishikimin e rezultatit të parakualifikimit. Huamarrësi i paraqet Bankës për referencë, dokumente të tjera të tilla në lidhje me parakualifikimin që Banka do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme. Kur BANKA nuk ka asnjë kundërshtim për dokumentet e mësipërme, Banka informon në mënyrën e duhur Huamarrësin me anë të një njoftimi në lidhje me rezultatin e parakualifikimit.

c) Kur miratohet procedura e ofertimit me dy zarfe, para hapjes së propozimeve të çmimeve, Huamarrësi i paraqet Bankës për rishikim dhe miratim, analizën e propozimeve teknike së bashku me një kërkesë për rishikimin e analizës së propozimeve teknike. Huamarrësi i paraqet Bankës për referencë, dokumente të tjera të tilla që Banka do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme. Kur Banka nuk ka asnjë kundërshtim, Banka informon Huamarrësin në mënyrën e duhur me anë të një njoftimi në lidhje me analizën e propozimeve teknike.

d) Para dërgimit të një njoftimi mbi lidhjen e kontratës për ofertuesin e suksesshëm, Huamarrësi do t'i paraqesë Bankës për rishikim dhe miratim analizën e ofertave dhe propozimin për lidhjen e kontratës, së bashku me një kërkesë për rishikimin e analizës së ofertave dhe propozimin për lidhjen e kontratës. (Kur është marrë hapi (c) më lart, "Analiza e ofertave" do të lexohet më pas si "Analiza e propozimeve të çmimeve"). Huamarrësi i paraqet Bankës për referencë dokumente të tjera të tilla mbi lidhjen e kontratës, si dokumentet e tenderit, siç Banka kërkon në mënyrë të arsyeshme. Kur Banka nuk ka asnjë kundërshtim ndaj dokumenteve të mësipërme, Banka informon Huamarrësin në mënyrën e duhur me anë të një njoftimi në lidhje me analizën e ofertave dhe propozimin për lidhjen e kontratës.

e) Kur, siç parashikohet në seksionin 5. 10 të udhëzimeve të prokurimit, Huamarrësi dëshiron të hedhë poshtë të gjitha ofertat ose të negociojë me ofertuesin e vlerësuar më pak (ose në pamundësi të arritjes së një rezultati të kënaqshëm të këtij negocimi, me ofertuesin e vlerësuar pas atij me pikë më të ulëta), me qëllim arritjen e një kontrate të kënaqshme, Huamarrësi informon Bankën për arsyet e tij, duke kërkuar rishikim dhe miratim paraprak. Kur Banka nuk ka asnjë kundërshtim, ajo informon Huamarrësin për miratimin e saj. Në rast të riofertimit, të gjitha procedurat e mëtejshme janë kryesisht në përputhje me nënseksionin (a) deri në (d).

f) Menjëherë pas ekzekutimit të një kontrate, Huamarrësi i paraqet Bankës për rishikim dhe miratim, një kopje të vërtetuar rregullisht së bashku me një kërkesë për Rishikimin e Kontratës (sipas formularit nr.2, bashkëlidhur këtij dokumenti). Kur Banka përcakton kontratën në përputhje me Marrëveshjen e huasë, Banka informon Huamarrësin në mënyrën e duhur me anë të një njoftimi në lidhje me kontratën.

g) Çdo modifikim ose anulim i një kontrate të rishikuar nga Banka kërkon miratimin paraprak me shkrim të Bankës për këtë, megjithatë, me kusht që çdo ndryshim që nuk përbën modifikim të rëndësishëm të kontratës dhe që nuk cenon çmimin e kontratës, nuk do të kërkojë këtë miratim nga Banka.

2. Për sa i përket çdo kontrate vlera e së cilës llogaritet të jetë jo më pak se një miliardë jenë japonezë (1 000 000 000): përveç të gjitha procedurave të specifikuara në pikën (1)(a) deri në (g) më lart, do të merren hapat e mëposhtëm.

Para reklamimit dhe/ose njoftimit të parakualifikimit, Huamarrësi i paraqet Bankës për rishikim dhe miratim dokumentet e parakualifikimit së bashku me një kërkesë për rishikimin e dokumenteve të parakualifikimit. Kur Banka nuk ka asnjë kundërshtim për dokumentet e mësipërme,

Banka informon në mënyrën e duhur Huamarrësin me anë të një njoftimi në lidhje me dokumentet e parakualifikimit. Kur Huamarrësi dëshiron të bëjë një ndryshim të rëndësishëm në dokumentet e mësipërme, miratimi i Bankës duhet të merret para se dokumentet t'u dërgohen aplikantëve të mundshëm.

3. Për sa i përket çdo kontrate vlera e së cilës llogaritet të jetë jo më pak se tre miliardë jenë japonezë (3 000 000 000): përveç të gjitha procedurave të specifikuara në pikën (1)(a) deri në (g) dhe 2 më lart, merren hapat e mëposhtëm.

Para ftesës për oferta, Huamarrësi i paraqet Bankës për rishikim dhe miratim, njoftimet dhe udhëzimet për ofertuesit, formularin e ofertës, draftkontratën e propozuar, specifikimet, skicat dhe të gjitha dokumentet e tjera në lidhje me ofertimin, së bashku me një kërkesë për rishikim të dokumenteve të tenderit. Kur Banka nuk ka asnjë kundërshtim për dokumentet e mësipërm, Banka informon në mënyrën e duhur Huamarrësin me anë të një njoftimi në lidhje me dokumentet e tenderit. Kur Huamarrësi dëshiron të bëjë një ndryshim të rëndësishëm në ndonjë prej dokumenteve të mësipërme, miratimi i Bankës duhet të merret para se dokumentet t'i dërgohen ofertuesve të mundshëm.

4. Për sa i përket çdo kontrate vlera e së cilës llogaritet të jetë më pak se pesëqind milionë jenë japonezë (500 000 000):

a) Menjëherë pas ekzekutimit të një kontrate, Huamarrësi i paraqet Bankës për rishikim dhe miratim, një kopje të vërtetuar rregullisht të kontratës së bashku me një kërkesë për rishikim të kontratës (sipas formularit nr.2 të bashkëlidhur në këtë dokument). Kur Banka e përcakton kontratën në përputhje me Marrëveshjen e Huasë, Banka informon Huamarrësin në mënyrën e duhur me anë të një njoftimi në lidhje me kontratën. Huamarrësi i paraqet Bankës për referencë dokumente të tjera të tilla në lidhje me kontratën, siç Banka kërkon në mënyrë të arsyeshme.

b) Çdo modifikim ose anulim i një kontrate të rishikuar nga Banka kërkon njoftimin paraprak me shkrim për Bankën në lidhje me këtë, megjithatë, me kusht që çdo ndryshim që nuk përbën një modifikim të rëndësishëm të kontratës dhe që nuk cenon çmimin e kontratës nuk do ta kërkojë këtë miratim nga ana e Bankës.

Seksioni 4. Rishikimi nga ana e Bankës i vendimeve në lidhje me punësimin e konsulentëve

Në rast të kontratave që duhet të financohen nga shumat e huasë të alokuara në kategorinë (B) të specifikuar në seksionin 1 të programit 2 të bashkëlidhur në këtë dokument, procedurat e mëposhtme, në përputhje me seksionin 4.02 të termave dhe kushteve të përgjithshme, i nënshtrohen rishikimit dhe miratimit të Bankës.

1. Para se propozimet të tërhiqen nga konsulentët, Huamarrësi do t'i paraqesë Bankës për rishikim dhe miratim, termat e referencës, listën e konsulentëve më të suksesshëm dhe ftesën, së bashku me një kërkesë për rishikim të këtyre dokumenteve. Kur Banka nuk ka asnjë kundërshtim për dokumentet e mësipërme, Banka informon në mënyrën e duhur Huamarrësin me anë të një njoftimi në lidhje me termat e referencës, listën e konsulentëve më të suksesshëm dhe ftesën. Çdo modifikim i mëtejshëm nga Huamarrësi i dokumenteve të mësipërm kërkon miratimin paraprak të Bankës.

2. Para ftesës së konsulentit të pozicionit më të lartë për të hyrë në negociata kontrate, Huamarrësi do t'i paraqesë Bankës për rishikim dhe miratim, rezultatet e vlerësimit të saj të propozimeve të marra, së bashku me një kërkesë për rishikim të raportit të vlerësimit mbi propozimet e konsulentëve. Kur Banka nuk ka asnjë kundërshtim për dokumentet e mësipërme, Banka informon në mënyrën e duhur Huamarrësin me anë të një njoftimi në lidhje me raportin e vlerësimit mbi propozimet e konsulentëve.

3. Nëse Huamarrësi dëshiron, siç parashikohet në seksionin 3.01 (2) të udhëzimeve të konsulentëve, të punësojë një konsulent specifik, Huamarrësi do të informojë Bankën me shkrim për arsyet e tij, për rishikimin dhe miratimin nga ana e Bankës, së bashku me ftesën dhe termat e referencës. Pas marrjes së miratimit të Bankës, Huamarrësi mund t'i dërgojë konsulentit të interesuar ftesën dhe termat e referencës. Nëse Huamarrësi e çmon propozimin e konsulentit të kënaqshëm, ai mund të negociojë më pas në lidhje me kushtet (duke përfshirë kushtet financiare) të kontratës.

4. Menjëherë pas ekzekutimit të një kontrate, Huamarrësi i paraqet Bankës për rishikim dhe miratim, një kopje të vërtetuar rregullisht të kontratës së bashku me një kërkesë për rishikim të kontratës (sipas formularit nr.3 të bashkëlidhur në këtë dokument). Kur Banka përcakton kontratën në

përputhje me Marrëveshjen e Huasë, Banka informon në mënyrën e duhur Huamarrësin me anë të një njoftimi në lidhje me kontratën.

5. Çdo modifikim ose anulim i një kontrate të rishikuar nga Banka kërkon miratimin paraprak me shkrim të Bankës për këtë, megjithatë, me kusht që çdo ndryshim që nuk përbën një modifikim të rëndësishëm të kontratës dhe që nuk cenon çmimin e kontratës nuk do të kërkojë një miratim të tillë nga Banka.

Formulari nr.1
Datë:
Ref. Nr.

BANKA JAPONEZE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR

Në vëmendje të: Drejtorit të Përgjithshëm, Departamenti i Zhvillimit të Asistencës IV

Zonja dhe Zotërinj:

KËRKESË PËR RISHIKIMIN E METODËS (VE) TË PROKURIMIT

Referencë: Marrëveshja e huasë nr.ABA-P3, datë ○○, 2008, për projektin e përmirësimit të sistemit të kanalizimeve të Tiranës së Madhe

Në përputhje me dispozitat përkatëse të Marrëveshjes së Huasë sipas referencës, me anë të kësaj ne paraqesim për rishikimin tuaj metodën (at) e prokurimit në fletën bashkëlidhur.

Do t'ju ishim mirënjohës nëse do të na njoftonit për miratimin tuaj.

Me respekt,

Për:
(Emri i Huamarrësit)
Nga:
(Firma e autorizuar)

Fleta e bashkëlidhur nr.

Titulli i projektit: Projekti i përmirësimit të kanalizimeve të Tiranës së Madhe

1. Metoda(t) e prokurimit
( ) Ofertimi (lokal) i kufizuar ndërkombëtar
( ) Blerjet (lokale) ndërkombëtare
( ) Kontraktimi i drejtpërdrejtë
( ) Të tjera ( )
2. Arsyet për përzgjedhjen e metodës (ve) të prokurimit në detaje
(Për shembull: konsideratat teknike, faktorët ekonomikë, përvojat dhe aftësitë)
3. Emri dhe kombësia e furnizuesit
(në rastet e ofertimit (lokal) të kufizuar ndërkombëtar dhe kontraktimin e drejtpërdrejtë)
4. Shuma e llogaritur e kontratës
Monedha e huaj
Monedha lokale
5. Zërat kryesorë të mbuluar nga kontrata
6. Tipi i kontratës
( ) Kontrata e ruajtjes
( ) Prokurimi i mallrave/pajisjeve/materialeve
( ) Kontrata e punimeve civile
( ) Prokurimi i shërbimeve
( ) Të tjera
7. Programi
i) Data e ekzekutimit të kontratës

ii) Data e dërgesës dhe/ose data për fillimin e punimeve/shërbimeve
iii) Data e përfundimit (për dorëzimin e ndërtimit)

Formulari nr. 2
Datë:
Ref. nr.

BANKA JAPONEZE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR

Në vëmendje të: Drejtorit të Përgjithshëm, Departamenti i Zhvillimit të Asistencës IV

Zonja dhe Zotërinj:

KËRKESË PËR RISHIKIM TË KONTRATËS

Referencë: Marrëveshja e huasë nr.ABA-P3 datë ○○, 2008, për projektin e përmirësimit të sistemit të kanalizimeve të Tiranës së Madhe

Në përputhje me dispozitat përkatëse të Marrëveshjes së Huasë sipas referencës, me anë të kësaj ne paraqesim për rishikim nga ana juaj një kopje të vërtetuar të kontratës të bashkëlidhur në këtë dokument. Hollësitë e Kontratës janë si më poshtë:

1. Numri dhe data e kontratës:
2. Emri dhe kombësia e furnizuesit:
3. Adresa e furnizuesit:
4. Emri i blerësit:
5. Çmimi i kontratës:
6. Shpenzimet e pranueshme:
7. Shuma e financimit të aplikuar:
(që përfaqëson % të shpenzimeve të pranueshme)
8. Përshkrimi dhe origjina e mallrave:
9. (Në rast se furnizuesi është një ndërmarrje e përbashkët) emri, kombësia dhe adresa e secilës kompani të ndërmarrjes së përbashkët:
(Kompania A):
(Kompania B):

Do t'ju ishim mirënjohës nëse do të na njoftonit për miratimin nga ana juaj të kontratës, duke na dërguar një Njoftim në lidhje me Kontratën.

Me respekt,
Për:
(Emri i Huamarrësit)
Nga:
(Nënshkrimi i autorizuar)

Formulari nr. 3
Datë:
Ref. nr.

BANKA JAPONEZE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR

Në vëmendje të: Drejtorit të Përgjithshëm, Departamenti i Zhvillimit të Asistencës IV

Zonja dhe Zotërinj:

KËRKESË PËR RISHIKIM TË KONTRATËS (për shërbimet e konsulencës)

Referencë: Marrëveshja e huasë Nr. ABA-P3 datë ○○, 2008, për projektin e përmirësimit të

sistemit të kanalizimeve të Tiranës së Madhe

Në përputhje me dispozitat përkatëse të Marrëveshjes së huasë sipas referencës, me anë të kësaj ne paraqesim për rishikim nga ana juaj një kopje të vërtetuar të kontratës të bashkëlidhur në këtë dokument. Hollësitë e kontratës janë si më poshtë:

1 Numri dhe data e kontratës:

2. Emri dhe kombësia e konsulentit:

3. Adresa e konsulentit:

4. Emri i punëdhënësit:

5. Çmimi i kontratës:

6. Shpenzimet e Pranueshme:

7. Shuma e financimit të aplikuar:

(që përfaqëson % të shpenzimeve të pranueshme)

8. (Në rast se konsulenti është një ndërmarrje e përbashkët) emri, kombësia dhe adresa e secilës kompani të Ndërmarrjes së Përbashkët:

(Kompania A):

(Kompania B):

Do t'ju ishim mirënjohës nëse do na njoftonit për miratimin nga ana juaj të Kontratës, duke na dërguar një njoftim në lidhje me kontratën.

Me respekt,

Për:

(Emri i Huamarrësit)

Nga:

(Nënshkrimi i autorizuar)

PROGRAMI 5
PROCEDURA E DETYRIMIT FINANCIAR

Procedura e detyrimit financiar për huatë ODA të korrikut 2007 (të amenduara) (në vijim referuar si "Procedura e detyrimit financiar") aplikohet *mutatis mutandis* për disbursimin e shumave të huasë për blerjen e mallrave dhe shërbimeve nga Furnizuesi (t) e vendit (ve) të pranueshme të origjinës në lidhje me pjesën e kontratës të deklaruar në monedhën e tregtueshme në mbarë botën të ndryshme nga ajo e Republikës së Shqipërisë, me përcaktimet plotësuese të mëposhtme:

1. Për sa i përket seksionit 1.(3) të procedurës së detyrimit financiar, Banka japoneze dhe Banka lëshuese do të jetë Banka e Tokyo-Mitsubishi UFJ, Ltd., Tokio.

2. Seksioni 2.(3) i procedurës së detyrimit financiar lexohet si më poshtë;

Kur Banka konstaton një L/C të tillë siç duhet dhe në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së huasë ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit dhe kushtet e kontratës përkatëse ndërmjet Huamarrësit dhe Furnizuesit, Banka do të nxjerrë L/COM për bankën japoneze në përputhje me formularin e bashkëlidhur JBIC-LOC.

PROGRAMI 6
PROCEDURA E RIMBURSIMIT

Procedura e rimbursimit për huatë ODA të tetorit 1999 (në vijim e referuar si "Procedura e rimbursimit") aplikohet *mutatis mutandis* për disbursimin e shumave të huasë për pagesat e bëra furnizuesit (ve) të vendit (ve) të pranueshme të origjinës, me përcaktimet plotësuese të mëposhtme:

1. Banka e caktuar për këmbimin, valutor në Tokio, sa herë që përmendet në këtë program, duke përfshirë procedurën e rimbursimit, do të jetë Banka e Tokyo-Mitsubishi UFJ, Ltd., Tokio.

2. Banka e autorizuar për këmbimin valutor në territoret e Huamarrësit, të përmendura në procedurën e rimbursimit, do të jetë Banka Amerikane e Shqipërisë (në vijim e referuar si "Banka e Huamarrësit").

3. Dokumentet mbështetëse që tregojnë çdo pagesë dhe përdorimin e saj, përmendur në pikën 2.(b) të procedurës së rimbursimit, do të jenë si më poshtë:

a) Për pagesat ndaj furnizuesve kundrejt dorëzimit/dërgimit të mallrave:

i) fatura e furnizuesit që specifikon mallrat me sasitë dhe çmimet e tyre që janë furnizuar/dërguar ose po furnizohen/dërgohen;

ii) faturën e ngarkesës ose dokumente të ngjashme që tregojnë dërgimin/dorëzimin e mallrave të renditura në faturë;

iii) kambialin ose ndonjë dokument të ngjashëm që tregon datën dhe shumën e pagesës së bërë furnizuesve; një faturë të thjeshtë nga furnizuesit që tregon datën dhe shumën e pagesës do të ishin të mjaftueshme.

b) Për pagesat ndaj furnizuesve të bëra para dorëzimit/dërgimit të mallrave:

kambiali ose ndonjë dokument i ngjashëm që tregon datën dhe shumën e pagesës së bërë furnizuesve; një faturë e thjeshtë nga furnizuesit që tregon datën dhe shumën e pagesës do të ishin të mjaftueshme.

c) Për pagesat në lidhje me shërbimet e konsulencës:

i) pretendimi i ngritur nga konsulentët që tregon me detaje të mjaftueshme, shërbimet e dhëna, periudhat e mbuluara dhe shumën e pagueshme për ta;

ii) çeku bankar i anuluar, draftkërkesa ose ndonjë dokument i ngjashëm që tregon datën dhe shumën e pagesës së bërë konsulentëve; një faturë e thjeshtë nga konsulentët që tregon datën dhe shumën e pagesës do të ishin të mjaftueshme.

d) Për pagesat në lidhje me shërbimet e tjera të ofruara:

i) kambiali, pretendimi ose fatura që specifikon natyrën e shërbimeve të dhëna dhe shumat e faturuara për këtë qëllim ;

ii) çeku bankar i anuluar, draftkërkesa ose ndonjë dokument i ngjashëm që tregon datën dhe shumën e pagesës së bërë; një faturë e thjeshtë që tregon datën dhe shumën e pagesës do të ishin të mjaftueshme.

Nëse këto shërbime kanë lidhje me importimin e mallrave (për shembull ngarkesa e mallrave, pagesat e sigurimit) duhet të jepen referenca të mjaftueshme për t'i dhënë mundësi Bankës të lidhë secilin prej këtyre zërave me mallrat specifike dhe kostoja e të cilave ka qenë financuar ose duhet të financohet nga Banka.

e) Për pagesat sipas kontratave të punimeve civile:

i) pretendimi, kambiali ose fatura e kontraktorit që tregon në detaje të mjaftueshme punën e kryer nga kontraktori dhe shumën e pretenduar për këtë qëllim, vërtetuar nga kryeinxhinieri ose oficeri i projektit i agjencisë ekzekutuese i caktuar për projektin, me qëllim që puna e kryer nga kontraktori të jetë e kënaqshme dhe në përputhje me kushtet e kontratës përkatëse, kjo certifikatë e bërë veçmas mund të jetë e mjaftueshme;

ii) çeku i anuluar bankar, draftkërkesa ose ndonjë dokument i ngjashëm që tregon datën dhe shumën e pagesës së bërë për kontraktorin; një faturë e thjeshtë për kontraktorin që tregon datën dhe

shumën e pagesës do të ishin të mjaftueshme.

4. Seksioni 3 i procedurës së rimbursimit lexohet si më poshtë;

Kur Banka konstaton se kërkesa për rimbursim është siç duhet dhe në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së huasë, Banka bën rimbursimin në jenë japonezë. Rimbursimi bëhet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e marrjes së kërkesës duke paguar në llogarinë jorezidente në jenë të Huamarrësit që do të hapet paraprakisht në bankën e caktuar të këmbimit valutor në Tokio, të përcaktuar në Marrëveshjen përkatëse të huasë, në përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse të Japonisë.

5. Shuma në Kërkesën për Rimbursim shprehet në jenë japonezë.

6. Formulari JBIC-SSP i bashkëlidhur në këtë dokument zëvendësohet me formularin JBIC-SSP të bashkëlidhur në Procedurën e Rimbursimit.

(Formulari JBIC - SSP)
Fletëpagesa përmbledhëse
Datë:
Nr serie.:

1. Transaksioni	2. Blerësi	3. Furnizuesi	4. *Kombësia e furnizuesit	5. Përshkrimi i mallrave dhe/ose shërbimeve	6. ** Kategoria	7. Origjina	8. Shuma dhe numri i kontratës.	9. Data e pagesës	10. *** Shuma e pagesës	11. **** Natyra e pagesës	12. Shuma e aplikuar për financim	13. ***** Raporti i disbursimit	14. JBIC nr. i Marrëveshjes për kontratën
1 2 3 4													
Totali													

I nënshkruari vërteton se furnizuesi (t) dhe mallrat dhe/ose shërbimet e deklaruara më lart janë të pranueshme sipas Marrëveshjes së huasë.

* Shënim për pikën 4. Kombësia e furnizuesit: Vendi në të cilin furnizuesi është inkorporuar dhe regjistruar.

** Shënim për pikën 6. Kategoria: Kategoria e përshkruar në seksionin 1, të programit 2.

*** Shënim për pikën 10. Shuma e pagesës: Nëse nuk është në jenë japonezë, deklaroni edhe shumën në monedhën në të cilën është bërë pagesa për furnizuesin (t) dhe konvertohet në shumë (shuma) të llogaritura në përputhje me pikën 4 të procedurës së rimbursimit dhe pikën 5 të programit 6 të Marrëveshjes së huasë, si dhe normën (at) e këmbimit.

**** Shënim për pikën 11. Natyra e pagesës: Një paradhënie, një pagesë në këste ose pagesa përfundimtare etj.

***** Shënim për pikën 13. Raporti i disbursimit: Raporti i shumës së aplikuar për financimin kundrejt shumës së pagesës në monedhën në të cilën pagesa ishte bërë për furnizuesin (t).

Nënshkrimi i autorizuar

PROGRAMI 7
PROCEDURA E TRANSFERIMIT

Procedura e transferimit e parashtruar në dy tipe në këtë dokument aplikohet për disbursimin e shumave të huasë për pagesat që duhet të bëhen për furnizuesin (ët) e vendit (eve) të pranueshme.

Banka e autorizuar e këmbimit valutor në Tokio, sa herë që përmendet në këtë program, do të jetë Banka e Tokyo-Mitsubishi UFJ, Ltd., Tokio, Japoni (në vijim e referuar si "Banka Paguese").

Tipi A : Në rast kur monedha e përdorur për pagesën aktuale ndaj furnizuesit (ve) tregtohet në mbarë botën në monedha të huaja të pranueshme për Bankën (jo lek shqiptar)

1. Kërkesa për disbursim

1. Kur Huamarrësi merr kërkesat për pagesën nga furnizuesi (t) nëpërmjet agjencisë ekzekutuese (sipas formularit CFP të bashkëlidhur në këtë dokument), Huamarrësi i kërkon Bankës të bëjë disbursim për një shumë që nuk tejkalon shumën aktualisht të kërkuar nga furnizuesi (t) duke i dërguar Bankës një kërkesë për disbursim në përputhje me formularin TRF të bashkëlidhur në këtë dokument. Secila kërkesë shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

a) Fletëpagesat përmbledhëse sipas formularit TRF-a të bashkëlidhur në këtë dokument;

b) Një kopje të udhëzimit të transferimit të tipit A drejtuar Bankës Paguese, sipas formularit të bashkëlidhur JBIC-TI-A;

c) Pretendimet për Pagesë që tregojnë shumën e cila duhet t'i paguhet furnizuesit (ve);

d) Dokumentet e mëposhtme mbështetëse që tregojnë secilën pagesë dhe përdorimin e tyre:

i) Për pagesat ndaj Furnizuesit (ve) kundrejt dërgimit/dorëzimit të mallrave dhe/ose shërbimeve – fatura e ngarkesës ose ndonjë dokument i ngjashëm që tregon dërgimin/dorëzimin e mallrave dhe/ose shërbimet e renditura në faturë;

ii) Për pagesat për shërbimet e konsulentëve – pretendimi i ngritur nga konsulentët që tregon me detaje të mjaftueshme shërbimet e ofertuara, periudhën e mbuluar dhe shumën e pagueshme për to;

iii) Për pagesat sipas kontratave të punimeve civile – pretendimi, kambiali ose fatura e kontraktorit që tregon me detaje të mjaftueshme punën e kryer nga kontraktori dhe shumën e kërkuar për këtë qëllim;

një vërtetim që të tregojë se puna e kryer nga kontraktori është e kënaqshme dhe në përputhje me kushtet e kontratës përkatëse; ky vërtetim do të nënshkruhet nga kryeinxhinieri ose oficeri i projektit të agjencisë ekzekutuese të caktuar për projektin.

2. Shuma e deklaruar në kërkesën për disbursim do të jetë në një monedhë të huaj të tregtueshme në mbarë botën, të pranueshme për Bankën, siç specifikohet nga furnizuesi (t).

3. Huamarrësi i dërgon Bankës Paguese udhëzimin e transferimit të tipit A (sipas formularit JBIC-TI-A) të shoqëruar nga kopja e kërkesës për disbursim dhe pretendimet për pagesën.

2. Disbursimi

1. Kur Banka konstaton se kërkesa për disbursim është siç duhet dhe në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së huasë, Banka do të bëjë disbursim në jenë japonezë. Disbursimi do të bëhet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pune nga marrja e kërkesës duke paguar në llogarinë jorezidente në jenë të Bankës Amerikane të Shqipërisë (në vijim referuar si "Banka e Huamarrësit") që do të hapet paraprakisht në Bankën Paguese, në përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse të Japonisë.

2. Në rast kur shuma e deklaruar në kërkesën për disbursim është në monedha të huaja të tregtueshme në mbarë botën, të pranueshme për Bankën, përveç jenit japonez, shuma e disbursimit në jenë japonezë do të llogaritet në normën e shitjes T/T të caktuar nga Banka Paguese dy (2) ditë pune para ditës kur është bërë disbursimi.

3. Pagesa për furnizuesin (t)

Menjëherë pasi shumat e huasë së disbursuar nga Banka të jenë kredituar në llogarinë jorezidente në jenë të Bankës së Huamarrësit , të përmendur në pikën 2 më lart, Huamarrësi do të shkaktojë që Banka Paguese të debitojë të njëjtën shumë kundrejt llogarisë së lartpërmendur për transferimin në llogarinë (të) korresponduese të furnizuesit (ve) të specifikuar në pretendimet për

pagesën. Njëkohësisht, Banka Paguese informon Bankën e Huamarrësit, furnizuesin (t) e interesuar dhe Bankën me rrugë kabllore për transferimin e lartpërmendur.

3. Delegimi i Autoritetit

1. Në këtë mënyrë, Huamarrësi përcakton Bankën e Huamarrësit si agjentin e tij për qëllime të marrjes së masave ose hyrjes në ndonjë marrëveshje të kërkuar ose lejuar sipas kësaj procedure transferimi.

2. Çdo masë e marrë ose marrëveshje e hyrë nga banka e Huamarrësit sipas autoritetit të dhënë ndaj Bankës së Huamarrësit është tërësisht detyruese për Huamarrësin dhe ka të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishte marrë nga Huamarrësi.

3. Autoriteti i dhënë për Bankën e Huamarrësit mund të revokohet ose ndryshohet nga marrëveshja ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës.

4. Marrëveshja

Huamarrësi shkakton që Banka e Huamarrësit të bëjë një marrëveshje të nevojshme me Bankën Paguese që përmban elementet e mëposhtme, në përputhje me autorizimin e dhënë Bankës së Huamarrësit, parashtruar në pikën 4 më lart:

1. Të hapë llogari jorezidente në jenë të Bankës së Huamarrësit në emër të Huamarrësit në Bankën Paguese.

2. Huamarrësi do t'i dërgojë Bankës Paguese udhëzimin e transferimit të tipit A (sipas formularit JBIC-TI-A) të shoqëruar me kopjen e kërkesës për disbursim dhe pretendimet për pagesën.

3. Menjëherë pasi disbursimi i bërë nga Banka është kredituar në llogarinë jorezidente në jenë të Bankës së Huamarrësit të përmendur në pikën 2 më lart, Banka Paguese do ta transferojë shumën e disbursuar në shumën (at) korresponduese të furnizuesit (ve) sipas udhëzimit të transferimit të tipit A të nxjerrë nga Huamarrësi.

5. Banka nuk është përgjegjëse për ndonjë humbje të shkaktuar nga Huamarrësi dhe/ose furnizuesi (t) në kohën e këmbimit për shkak të ndonjë ndryshimi midis pretendimeve të pagesave nga furnizuesi (t) për Huamarrësin dhe pagesave aktuale për furnizuesin (t).

Tipi B: Në rast kur monedha e përdorur për pagesën aktuale ndaj furnizuesit (ve) është leku shqiptar.

1. Kërkesa për disbursim

1. Kur Huamarrësi merr pretendimet për pagesën nga furnizuesi (t) nëpërmjet agjencisë ekzekutuese (sipas formularit CFP të bashkëlidhur në këtë dokument), Huamarrësi i kërkon Bankës të bëjë disbursim për një shumë që nuk tejkalon shumën e kërkuar nga furnizuesi (t) duke i dërguar Bankës një kërkesë për disbursim në përputhje me formularin TRF të bashkëlidhur. Secila kërkesë shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

a) Fletëpagesat përmbledhëse sipas formularit të bashkëlidhur TRF-a

b) Një kopje të udhëzimit të transferimit të tipit B të drejtuar Bankës së Huamarrësit sipas formularit të bashkëlidhur JBIC-TI-B

c) Pretendimet për pagesën që tregojnë shumën e cila duhet t'i paguhet furnizuesit (ve)

d) Dokumentet e mëposhtme mbështetëse që tregojnë secilën pagesë dhe përdorimin e tyre:

i) Për pagesat ndaj furnizuesit (ve) kundrejt dërgimit/dorëzimit të mallrave dhe/ose shërbimeve – fatura e ngarkesës ose ndonjë dokument i ngjashëm që tregon dërgimin/dorëzimin e mallrave dhe/ose shërbimet e renditura në faturë;

ii) Për pagesat për shërbimet e konsulentëve - pretendimi i ngritur nga konsulentët që tregon me detaje të mjaftueshme shërbimet e ofertuara, periudhën e mbuluar dhe shumën e pagueshme për to;

iii) Për pagesat sipas kontratave të punimeve civile – pretendimi, kambiali ose fatura e kontraktorit që tregon me detaje të mjaftueshme punën e kryer nga kontraktori dhe shumën e kërkuar për këtë qëllim;

një vërtetim që të tregojë se puna e kryer nga kontraktori është e kënaqshme dhe në përputhje me kushtet e kontratës përkatëse; ky vërtetim do të nënshkruhet nga kryeinxhinieri ose oficeri i projektit të agjencisë ekzekutuese të caktuar për projektin.

2. Shuma e deklaruar në kërkesën për disbursim do të jetë në jenë japonezë, konvertuar në normën e blerjes T/T të përcaktuar nga një bankë e autorizuar këmbimi valutor në Shqipëri në ditën që vjen menjëherë para ditës në të cilën është bërë kërkesa për disbursim. Shuma që duhet të paguhet në

lekë shqiptare dhe norma e këmbimit e përdorur për këmbim në jenë japonezë përshkruhet në fletëpagesat përmbledhëse sipas formularit TRF-a, së bashku me provën e kësaj norme këmbimi.

3. Pavarësisht nga përcaktimi në pikën (2) më lart, norma e referencës e përcaktuar nga Banka e Huamarrësit në gazetat kryesore mund të përdoret gjithashtu.

4. Huamarrësi i paraqet Bankës së Huamarrësit udhëzimin e transferimit të tipit B (sipas formularit JBIC-TI-B) të shoqëruar me kopjen e kërkesës për disbursim dhe pretendimet për pagesën.

2. Disbursimi

Kur Banka konstaton se kërkesa për disbursim është siç duhet dhe në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Huasë, Banka do të bëjë disbursim në jenë japonezë. Disbursimi do të bëhet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pune nga marrja e kërkesës duke paguar në llogarinë jorezidente në jenë të Bankës së Huamarrësit që do të hapet paraprakisht në Bankën Paguese, në përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse të Japonisë.

3. Pagesa për furnizuesin (t)

Menjëherë pasi shumat e huasë së disbursuar nga Banka të jenë kredituar në llogarinë jorezidente në jenë të Bankës së Huamarrësit , të përmendur në pikën 2 më lart, Huamarrësi do të bëjë që Banka Paguese të debitojë të njëjtën shumë kundrejt llogarisë së lartpërmendur për transferimin në llogarinë e rregullt të Bankës së Huamarrësit sipas një konsulence kabllore në Bankën e Huamarrësit.

Pas marrjes së konsulencës kabllore nga Banka Paguese, Banka e Huamarrësit do të kreditojë menjëherë shumën në lekë shqiptarë, aktualisht të kërkuar nga furnizuesi (t) për në llogarinë (të) korresponduese të furnizuesit (ve) të specifikuara në pretendimet për pagesën.

4. Delegimi i autoritetit

1. Në këtë mënyrë, Huamarrësi përcakton Bankën e Huamarrësit si agjentin e tij për qëllime të marrjes së masave ose hyrjes në ndonjë marrëveshje të kërkuar ose lejuar sipas kësaj procedure Transferimi.

2. Çdo masë e marrë ose marrëveshje e hyrë nga Banka e Huamarrësit sipas autoritetit të dhënë ndaj Bankës së Huamarrësit është tërësisht detyruese për Huamarrësin dhe ka të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishte marrë nga Huamarrësi.

3. Autoriteti i dhënë për Bankën e Huamarrësit mund të revokohet ose ndryshohet nga marrëveshja ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës.

5. Marrëveshja

1. Huamarrësi bën që Banka e Huamarrësit të marrë masat e nevojshme me Bankën Paguese duke përmbajtur elementet e mëposhtme në përputhje me autorizimin e dhënë Bankës së Huamarrësit, parashtruar në pikën 4 më lart:

a) Të hapë llogari jorezidente në jenë të Bankës së Huamarrësit në emër të Huamarrësit në Bankën Paguese.

b) Të lejojë Bankën Paguese t'i japë konsulencë kabllore Bankës së Huamarrësit për disbursimin nga Banka.

2. Huamarrësi do t'i dërgojë Bankës Paguese udhëzimin e transferimit të tipit A (sipas formularit JBIC-TI-A) të shoqëruar me kopjen e kërkesës për disbursim dhe pretendimet për pagesën.

a) Pas marrjes së konsulencës kabllore nga Banka Paguese, Banka e Huamarrësit do të kreditojë menjëherë shumën në lekë shqiptare aktualisht të kërkuar nga furnizuesi (t) në llogarinë (të) korresponduese të furnizuesit (ve) sipas udhëzimit të transferimit të tipit B të nxjerrë nga Huamarrësi.

6. Banka nuk është përgjegjëse për ndonjë humbje të shkaktuar nga Huamarrësi dhe/ose furnizuesi (t) në kohën e këmbimit për shkak të ndonjë ndryshimi midis pretendimeve të pagesave nga furnizuesi (t) për Huamarrësin dhe pagesave aktuale për furnizuesin (t).

Formular TRF

KËRKESË PËR DISBURSIM

Datë:
Marrëveshja e huasë nr.: ABA-P3
App. nr. Serie:
5611

Drejtuar: BANKËS JAPONEZE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR
Në vëmendje të: Drejtorit të Përgjithshëm, Departamenti i Zhvillimit të Asistencës IV

Zotërinj:

1. Sipas Marrëveshjes së huasë nr.ABA-P3, datë ○○, 2008, për projektin e përmirësimit të sistemit të kanalizimeve të Tiranës së Madhe ndërmjet Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (në vijim e referuar si "Banka" dhe Qeverise së Republikës së Shqipërisë, me anë të kësaj, i nënshkruari kërkon disbursim sipas Marrëveshjes së mësipërme, shumën prej _____ (me fjalë _____) për pagesën e shpenzimeve të përshkruara në fletën (t) përmbledhëse të bashkëlidhura në këtë dokument.

2. I nënshkruari nuk ka kërkuar më parë disbursim të ndonjë shume nga huaja për qëllim të përballimit të shpenzimeve të përshkruara në fletën (t) përmbledhëse. I nënshkruari nuk ka përftuar, as nuk do të përftojë fonde për këtë qëllim nga shumat e ndonjë huaje, kredie ose granti tjetër në dispozicion të të nënshkruarit.

3. I nënshkruari vërteton se:

a) Shpenzimet e përshkruara në fletën (t) përmbledhëse janë bërë për qëllimet e specifikuara në Marrëveshjen e huasë ;

b) mallrat dhe shërbimet e blera me këto shpenzime janë prokuruar në përputhje me procedurat e zbatueshme të prokurimit të rëna dakord me Bankën sipas Marrëveshjes së mësipërme të huasë dhe kostoja dhe kushtet e blerjes së saj janë të arsyeshme;

c) mallrat dhe shërbimet e lartpërmendura ishin furnizuar ose do të furnizohen nga furnizuesi (t) e specifikuar në fletën (t) e bashkëlidhura përmbledhëse dhe ishin prodhuar ose do të prodhohen në (ose në rast të shërbimeve, furnizuar nga) vendi (et) e pranueshme për huanë e Bankës.

4. Ju lutem disbursoni shumën e kërkuar këtu, duke paguar në llogarinë jorezidente në jenë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në Bankën e Tokyo-Mitsubishi UFJ, Ltd., Tokio, Japoni.

5. Kjo kërkesë përbëhet nga ___faqe dhe _____nënshkruhet dhe fletë (t) përmbledhëse numërtohen.

Me respekt,
Për:
(Emri i Huamarrësit)
Nga :
(Nënshkrimi i autorizuar)

Formulari TRF-a
Datë:

Fletëpagesë përmbledhëse

nr. serie.:

(Tipi A ose Tipi B)

1	2	3	4	_	6		7	8
JBIC Nr i Marrëveshjes ○○-○○/C-	Përshkrimi i mallrave dhe/ose shërbimeve	Emri dhe adresa e furnizuesit	Kategoria	Shuma e kontratës	Shuma që duhet të paguhet në monedhën e Kontratës		Shuma e akumuluar	Vërejtje
				JBIC Shuma e rënë dakord	Shuma e aplikuar për financimin JBIC (=shuma e pretenduar këtë herë)	Shuma që duhet të paguhet në monedhën që duhet të merret nga furnizuesi	Shuma e akumuluar e financimit JBIC tashmë të paguar	

Shënime. 1. Shuma e aplikuar për financimin JBIC llogaritet si më poshtë: _____
(Nëse për këtë llogaritje përdoret një raport disbursimi, ju lutem tregojeni atë specifikisht.)

2. Shuma e aplikuar për financimin JBIC = _____ Lek shqiptar i barasvlershëm me _____ jenë japonezë (vetëm tipi B)

3. Shuma e aplikuar për financimin JBIC është e barasvlershme me shumën e pretenduar të treguar në kopjen e bashkëlidhur të pretendimeve për pagesën (Formulari CFP)

4. Norma e këmbimit rrumbullakoset në katër (4) numra dhjetorë. Mos merrni në konsideratë jenin japonez poshtë njëshit (1). (vetëm tipi B)

5. Kolona 8 duhet të tregojë nëse pagesa është parapagim ose paradhënie ose këst.
(nëse është kështu, numri i këstit dhe muaji/periudha korresponduese) ose pagesa përfundimtare në shlyerje të plotë.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë

Nga:
(Nënshkrimi i autorizuar)

Formulari JBIC-TI-A

UDHËZIM TRANSFERIMI TIPI A

Datë:
Marrëveshja e huasë nr.: ABA-P3
App. nr. serie.:

Drejtuar: Bankës së Tokyo-Mitsubishi UFJ, Ltd., Tokio, Japoni

Sipas Marrëveshjes Bankare ndërmjet Bankës së Tokyo-Mitsubishi UFJ, Ltd., Tokio, Japoni dhe Bankës Amerikane të Shqipërisë, të datës _____ me anë të kësaj ne ju kërkojmë të transferoni shumën e disbursuar nga Banka kundrejt kërkesës sonë për disbursimin nr. _____datë _____ në llogarinë e furnizuesit përkatës të përmendur në pretendimet për pagesën nr._____ datë _____ bashkëlidhur kërkesës për disbursim të përmendur më lart.

Për:

(Emri dhe adresa e Huamarrësit)

Nga:

(Nënshkrimi i autorizuar)

Bashkëlidhur. Kërkesa për pretendimet e disbursimit për pagesën

Formulari JBIC-TI-B

UDHËZIM TRANSFERIMI TIPI B

Datë:

Marrëveshja e huasë nr.: ABA-P3
App. nr. serie.:

Drejtuar: Një banke tregtare të përcaktuar nga Huamarrësi dhe të pranueshme për Bankën

Me marrjen e konsulencës kabllore nga Banka Paguese, Banka Amerikane e Shqipërisë do të kreditojë menjëherë shumën në lek shqiptar, aktualisht të kërkuar nga furnizuesi në llogarinë korresponduese të furnizuesit.

Për:
(Emri dhe adresa e Huamarrësit)

Nga:
(Nënshkrimi i autorizuar)

Bashkëlidhur. Kërkesa për pretendimet e disbursimit për pagesën

Formulari CFP

PRETENDIMET PËR PAGESËN

Datë :
Marrëveshja e huasë nr.:ABA-P3
App. nr. Serie. :

Drejtuar: (Emri dhe adresa e agjencisë ekzektuese)

Me anë të kësaj, ne paraqesim pretendimet për pagesën ndaj jush për ecurinë e punës, në përmbajtjen e mëposhtme.

1. Emri i përfituesit:
2. Nr. dhe data e kontratës:
3. Njoftimi në lidhje me numrin dhe datën e kontratës (nëse ka):
4. Përshkrimi i mallrave dhe/ose shërbimeve të kryera:
5. Shuma e pretenduar:
6. Shuma e akumuluar, tashmë e paguar:
7. Shuma totale (5. + 6.):

Ju lutem paguani shumën e pretenduar në pikën 5 më lart në llogarinë e mëposhtme.
Numri i llogarisë:
Emri i bankës së furnizuesit:
Adresa e bankës së furnizuesit:
Adresa kabllore:

Për:
(Emri i furnizuesit)
Nga:
(Nënshkrimi i autorizuar)